VENDIM
Nr.462, datë 16.4.2008

PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË NJËSISË SË MBIKËQYRJES SË LOJËRAVE TË FATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 30/1 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Njësisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (NJMLF), me statusin e personit juridik, publik, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, me seli në Tiranë. NJMLF-ja ka vulën dhe stemën e vet, në përputhje me vendimin nr.474, datë 10.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj".

2. NJMLF-ja ka objekt veprimtarie mbikëqyrjen dhe ushtrimin e kontrollit për zbatimin e ligjshmërisë nga subjektet e licencuara, në fushën e lojërave të fatit, kazinotë dhe hipodromet, në mbështetje të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar.

3. NJMLF-ja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, kryen këto funksione:

a) Mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e subjekteve të licencuara për luajtjen e lojërave elektronike, llotarisë kombëtare dhe lojërave aritmetike, brenda dhe jashtë sallave, në të gjithë territorin e vendit, për:

i) mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë e për organizimin e lojërave, në përputhje me përcaktimet e bëra në licencë, me legjislacionin për lojërat e fatit dhe me aktet nënligjore në fuqi;

ii) luajtjen e lojës në përputhje me rregulloren dhe standardin e biletës, të miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë;

iii) certifikimin e pajisjeve nga DPMK-ja, si dhe origjinën dhe kohën e përdorimit të tyre.

b) Mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e subjekteve të licencuara në kategoritë "konkurse për parashikime sportive", "baste" dhe "garat sportive, që zhvillohen në hipodrom", në të gjithë territorin e vendit, për:

i) mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë e për organizimin e lojërave sportive, në përputhje me përcaktimet e bëra në licencë, me legjislacionin për lojërat e fatit dhe me aktet nënligjore në fuqi;

ii) luajtjen e lojës, në përputhje me rregulloren, standardin e biletës, të miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë;

iii) luajtjen e "basteve sportive", *on-line*, nëpërmjet internetit.

c) Mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e shoqërive, të licencuara për ushtrim veprimtarie për kazino, në përputhje me legjislacionin dhe me aktet nënligjore në fuqi, mënyrën e sigurimit të kazinosë dhe të kontrollit të pjesëmarrësve në lojë, gjatë hyrjes në sallë, certifikimin e pajisjeve nga DPMK-ja dhe kohën e përdorimit të tyre, luajtjen e lojërave, në përputhje me rregulloret përkatëse, të miratuara nga ministri përgjegjës për ekonominë.

ç) Mbikëqyr dhe kontrollon subjektet e pajisura me autorizim nga ministri përgjegjës për ekonominë, për luajtjen e lojërave promocionale të fatit.

d) Mban regjistrin e subjekteve të licencuara dhe të sallave të hapura prej tyre në të gjithë territorin e vendit, numrin e automatëve/pajisjeve për çdo sallë dhe karakteristikat specifike të tyre, numrin e punonjësve dhe kualifikimin përkatës, numrin e biletave të llotarisë kombëtare, të

hedhura në treg dhe ato të shitura; numrin e shorteve të hedhura nga organizatori i llotarisë kombëtare dhe organizatorët e telebingos; të ardhurat dhe fitimin e subjekteve të licencuara në lojërat e fatit, si dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore prej tyre, si të rakorduara në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe degët e saj në rrethe.

dh) U raporton, në afate të përcaktuara dhe sa herë që i kërkohet, ministrit përgjegjës për ekonominë dhe Komitetit të Lojërave të Fatit, për rregullsinë e veprimtarisë së subjekteve të licencuara për luajtjen e lojërave të fatit; kontrollet e ushtruara dhe rezultatet e tyre; sanksionet e vendosura për shkelje të dispozitave ligjore.

4. NJMLF-ja harton rregulloren e saj, e cila miratohet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

5. NJMLF-ja është institucion, që financohet me burimet e veta. Kjo njësi financohet nga Buxheti i Shtetit, deri në çastin kur të ardhurat e saj të jenë të mjaftueshme, për të siguruar vetëfinancimin.

6. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, t'i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për llogari të Njësisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, i cili të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Ky fond përbëhet nga shpenzime koherente, në shumën 8 800 000 (tetë milionë e tetëqind mijë) lekë dhe shpenzime kapitale (investime), në shumën 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë.

7. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Njësisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit rregullohen me Kodin e Punës dhe me aktet e tjera nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

8. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA DHE ORGANIKA E NJËSISË SË MBIKËQYRJES SË LOJËRAVE TË FATIT

POZICIONI	**Numri i punonjësve**
Drejtor	1
Sekretar	1
Shofer	1
Sektori i mbikëqyrjes për kategoritë e lojërave "Kazino", "Hipodrome", "Llotari kombëtare", lojërave "Aritmetike" dhe "Elektronike"	
- Përgjegjës sektori	1
- Inspektor	3
Sektori i Mbikëqyrjes për kategoritë e lojërave "Baste sportive" dhe "Konkurs për parashikimet sportive"	
- Përgjegjës sektori	1
- Inspektor	3
TOTALI I NËPUNËSVE	11

STRUKTURA E PAGAVE

Funksioni	**Numri**	**Kategoria e pagës**
Drejtor	1	II-b
Sekretar	1	IV-a
Shofer		

Përgjegjës sektori/Mbikëqyrjes për kategoritë e lojërave "Kazino", "Hipodrome", "Llotari kombëtare", Lojërave "Aritmetike" dhe "Elektronike"	1	III-a/1
Inspektor	2	III-b
Inspektor	1	IV-a
Përgjegjës sektori/Sektori i mbikëqyrjes për kategoritë e lojërave "Baste sportive" dhe "Konkurs për parashikimet sportive"	1	III-a/l
Inspektor	2	III-b
Inspektor	1	IV-a
TOTALI I NËPUNËSVE	**11**	